



Prishtinë: 05.08.2010

Kodi i ZRRE-së: V_261_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_391_04_10

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_391_04_10** ;
5. Apelimi i KEK-ut me datë 21.07.2010;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

Në mbledhjen e mbajtur më 05 gusht 2010 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET apelimi i KEK-ut për ankesën e konsumatorit Shefqet Jahjaga (shifra e konsumatorit DPR – 32018) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 21.12.2009 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 08.12.2009, lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 06.08.2007 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për kontrollin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë konstatuar dyshohet se xhamin e njehsorit e ka të dëmtuar dhe se njehsori elektrik duhet të dërgohet në kalibrim.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 01052 datë 06.08.2007
- Me datë 24.08.2007 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 17693759 dhe kanë vendosur për matje njehsorin nr. 1258331.
Provë: Vërtetim mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 0578 datë 24.08.2007

- Në periudhën 03/2008 KEK-u ka hequr nga matja njehsorin nr. 1258331 dhe ka vendosur për matje njehsorin nr. 40863005.
- Me datë 25.09.2007 punëtorët e qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 17693759, ku është konstatuar se njehsori elektrik vulat (bllobat) shtetërore i ka në rregull, për rreth qelqit nga ana e majtë është futur shiriti filmik dhe është penguar puna e diskut si dhe ne brendi të njehsorit ka pluhur të shiritit filmik.
Provë: Procesverbali me nr. 08/25 i datës 25.09.2007
- Me datë 24.09.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe kanë bërë regjistrimin pajisjeve elektrike te konsumatori dhe ka regjistruar të dhënat teknike të pikës matëse.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 342315 i datës 24.09.2009
- Me datë 30.09.2009 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR09HP07897 në vlerë prej 456.44 €.
Provë: Fatura DPR09HP07897 e datës 30.09.2009
- Me datë 07.10.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 08.12.2009 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke thirrur në procesverbalin e kontrollës dhe të kalibrimit.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 08.12.2009
- Me datë 21.12.2009 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: ZRRE/DMK_V_ 391_04_10 dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi (KEK-u) nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** KEK-un për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar